VENDIM
Nr. 84, datë 30.1.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 947, DATË 2.9.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS KOLONJË TË QARKUT TË FIERIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën që i bashkëlidhet vendimit nr. 947, datë 2.9.2009 të Këshillit të Ministrave, shtohen pronat me numrat rendorë 319-373 (treqind e nëntëmbëdhjetë deri në treqind e shtatëdhjetë e tre), sipas lidhjes nr. 1 dhe formularëve, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i pasurive të paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Kolonjë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Kolonjë Lidhja nr. 1

Numrat rendorë sipas listës së inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
331-364	Tokë bujqësore produktive	Në përdorim
365-366	Infrastrukturë rrugore	Në pronësi
367	Zhvillim ekonomik	Në pronësi
368-370	Tokë joproduktive	Në pronësi